



SHTETI ME MOS VEPRIM, PRIVON NGA JETA SEBAHATE SOPIN

Autorët: Arrita Reznici dhe Gzim Shala

Redaktor: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Yll Zekaj dhe Jeton Hasani

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Mars, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I. Kronologjia e trajtimit të rastit viktimës së dhunës - tani të ndjerës Sebahate Sopi	4
II. Dështimet e shtetit në zbatimin e Konventës së Stambollit	5
III. Përpjekjet e dështuara të Prokurorit të Shtetit për të amnistuar veten	6
IV. Jurisprudenca e Strasburgut në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetë	8
V. Rekomandimet.....	11

I. Kronologjia e trajtimit të rastit viktimës së dhunës - tani të ndjerës Sebahate Sopi

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) reagojnë fuqishëm ndaj neglizhencës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe Policisë së Kosovës në rastin e tani të ndjerës Sebahate Sopi, e cila mënyrë e veprimit i ka cenuar tani të ndjerës të drejtën më esenciale të njeriut, atë për jetë.

Më 14 mars 2021, L.S. dyshohet se në lagjen “Emshir” në Prishtinë me armë zjarri ka vrarë fillimisht bashkëshorten e tij Sebahate Sopi, e më pas ka vrarë edhe veten. Lidhur me këtë rast, Prokuroria Themelore në Prishtinë më 16 mars ka lëshuar komunikatë për media, ku ka thënë se ky rast ishte iniciuar në Prokurorinë Themelore të Prishtinës më 3 mars 2021, dhe se kjo prokurori kishte iniciuar rast penal kundër tani të ndjerit L.S. në drejtim të veprës penale “*dhunë në familje*”.

“Sipas shkresave të lëndës rezultoi se vajza e të dëmtuarës, S.S. (tani e ndjera), e para e kishte raportuar rastin në polici, ku menjëherë janë ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore dhe është intervistuar e dëmtuara S.S., e cila në deklaratën e saj ka theksuar se me këtë datë kishte pasur mosmarrëveshje me ish-bashkëshortin e saj dhe i njëjti e kishte sulmuar fizikisht, por që ka refuzuar të pranojë ndihmën mjekësore pasi ka qenë diçka momentale dhe nuk dëshiron që më tutje të vazhdojë me rastin. Prokurori i Shtetit, ka autorizuar policinë që të ndërmarrë edhe veprime tjera të nevojshme hetimore, ku është intervistuar i dyshuari, i cili e ka mohuar ta ketë sulmuar ish-bashkëshorten e tij. Për të sqaruar ende këto rrethana të ekzistimit të veprës penale, prokuroria i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, ashtu që, më 04.03.2021, ka ftuar në polici për deklaratë shtesë të dëmtuarën S.S., por e njëjta përsëri nuk është paraqitur në Stacion policor”, thuhet në komunikatën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Nga data 4 mars 2021, Prokurori i Shtetit nuk ka ndërmarr asnjë veprim hetimor apo veprim tjetër për të zbardhur rastin apo masë për t'i ofruar mbrojtjen e nevojshme të viktimës Sebahate Sopi. Ajo është vrarë më 14 mars 2021.

Për arsyet si në vijim, IKD dhe RrGK vlerëson se Republika e Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe institucionet tjera shtetërore përmes mos veprimit të tyre, mos përmbushjes së obligimeve ligjore në rastet kur cenohet integriteti i grave tek veprat penale të dhunës në familje ia kanë shkelur tani të ndjerës Sebahate Sopi të drejtën për jetë, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë, si e drejta më elementare njerëzore, nga e cila e drejtë derivojnë edhe të gjitha të drejtat e tjera.

Dështimi i Prokurorit të Shtetit për të përmbushur mandatin kushtetues dhe ligjor për të ndërmarrë veprime dhe masa që garantojnë të drejtën në jetë, vie në kohën kur Republika e Kosovës ka marr obligim për të zbatuar drejtpërdrejt në rendin

juridik kosovar Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Tutje: *Konventë e Stambollit*).

II. Dështimet e shtetit në zbatimin e Konventës së Stambollit

Parimet bazë të kësaj Konvente që janë edhe obligim i drejtpërdrejt për të zbatuar të njëjtat nga ana e institucioneve në Kosovë, me theks të veçantë sistemi i drejtësisë janë:

- Përgjegjësia e Shtetit për të parandaluar të gjitha format e dhunës ndaj grave, të mbroj gratë, të cilat janë të ballafaquar me dhunë në familje dhe të ndjek penalisht kryesit e veprës penale;
- Shteti **DUHET** të hetoj dyshimet për dhunë në familje dhe të ndjek penalisht kryesit e kësaj vepre penale;
- Shteti **DUHET** të mbroj dhe mbështes gratë që janë subjekt i dhunës në familje, duke larguar kryesin e veprës penale nga shtëpia dhe t'i sigurohet viktimës së dhunës në familje mjedis i sigurtë për jetën dhe mirëqenien e saj;
- Shtetit **DUHET** të sigurojë qasje dhe bashkëpunim të koordinuar në mes të agjencive që zbatojnë ligjin, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera relevante për të ofruar mbështetje dhe mbrojtje adekuate dhe efikase ndaj viktimave të dhunës në familje nga çdo dhunë tjetër e mëtutjeshme.
- Viktimat e dhunës në familje **DUHET** të kenë informacion dhe qasje 24/7 për të pranuar ndihmë apo shërbime të kujdesit.

Këto të drejta por edhe të drejta tjera lidhur me viktimat e dhunës në familje, janë të inkorporuara edhe në Kushtetutën e Kosovës, si dhe në një varg të ligjeve që sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat e grave në Kosovë.

Fenomeni i dhunës në familje, shtimi i numrit të rasteve të dhunës në familje gjatë Pandemisë, përfshirë rritja e numrit të vrasjeve në Kosovë, do të duhej të ishte alarm për institucionet kushtetuese në Kosovë për të adresuar këtë fenomen me seriozitet, në mënyrë efektive, adekuate dhe të përgjegjshme. Ky alarm është ngritur nga të gjitha raportet ndërkombëtare dhe vendore, përfshirë këtu edhe raportin e IKD-së (*Kriminaliteti në pandemi*).

Fatkeqësisht, në rastin e viktimës Sebahate Sopi, vazhdon praktika e instaluar e neglizhencës së institucioneve të shtetit, me theks të veçantë Prokurorisë për të trajtuar këto raste sipas rëndësisë dhe specifikave që kanë. Përkundrazi, qasja e këtij institucioni para vrasjes dhe pas vrasjes së viktimës dëshmon joseriozitet, përpjekje amatoreske për t'i ikur përgjegjësisë, dhe relativizim i skajshëm lidhur me privimin nga jeta të një viktime të dhunës në familje.

III. Përpjekjet e dështuara të Prokurorit të Shtetit për të amnistuar veten

Komunikata e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, është ofendim jo vetëm ndaj familjarëve të viktimës Sopi, por është ofendim për çdo grua në Kosovë, dhe përqim i mesazhit se mbrojtja e të drejtave të grave dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë nuk është prioritet i institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Shkeljen e të drejtës në jetë nga ana e shtetit ndaj Sebahate Sopit përmes mos veprimit e ka dëshmuar vetë Prokuroria Themelore në Prishtinë përmes komunikatës për media të lëshuar më 16 mars 2021.

Bazuar në faktet e paraqitura në këtë komunikatë, Prokuroria Themelore në Prishtinë e ka pasur rastin e deponuar 11 ditë para ditës kritike. Veprimet e kësaj prokurorie në rastin konkret flasin për një rol tërësisht pasiv të Prokurorit të Shtetit në drejtim të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit të vrasjes.

Përmes kësaj komunikate, Prokurori i Shtetit ka tentuar ta mbulojë përgjegjësinë përmes dy arsyetimeve:

1) E dëmtuara ka refuzuar të pranojë ndihmën mjekësore pasi ka qenë diçka momentale dhe nuk dëshiron që më tutje të vazhdojë me rastin dhe

2) E dëmtuara nuk është paraqitur për ri-intervistim më 4 mars 2021.

Pas datës 4 mars 2021, bazuar në komunikatën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kjo prokurori nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër brenda kompetencave të saja për 10 ditë rresht, deri në ditën kritike kur edhe ka ndodhur vrasja. Për më tepër, prokurori i këtij rasti në asnjë mënyrë nuk ka vepruar sipas faktit se viktimja në këtë rast ka qenë e ndjeshme. Për më tepër, IKD ka marrë konfirmimin nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave se L.S. gjatë vitit 2019 kishte qenë në paraburgim për shkak të dhunës në familje të ushtruar ndaj tani të ndjerës Sebahate Sopi, si dhe deri në fund të vitit 2020 ndaj tij kishte qenë në fuqi edhe një urdhër mbrojtje. Pra, shqetësimet e tani të ndjerës për dhunë në familje kishin qenë të vazhdueshme. Mirëpo, në komunikatën për media, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka fshehur faktet lidhur me dhunën sistematike të ushtruar ndaj Sebahate Sopit, si dhe masat e ndërmarra nga ana e ZMNV-së për të parandaluar këtë rast.

Tutje, fakti se tani e ndjera nuk ka dëshiruar që më tutje të vazhdojë me rastin nuk është fare relevante. Vepra penale e “*dhunës në familje*” e përcaktuar me nenin 248 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës **ndiqet sipas detyrës zyrtare**, dhe prokurori i rastit ka pasur obligim që ta trajtojë me seriozitet, efikasitet, profesionalizëm dhe prioritet këtë rast, pa marrë parasysh mungesën e vullnetit të shprehur nga ana e të dëmtuarës.

Për më tepër, deklarata të tilla të të dëmtuarave në këto raste janë pothuajse të zakonshme, të cilat vinë si rezultat i rrethanave kulturore por edhe presioneve nga jashtë, qoftë nga bashkëshorti (i pandehuri) apo edhe rrethi familjar. Përballë domosdoshmërisë së prokurorit të rastit që mungesën e gatishmërisë së viktimës ta trajtojë nën këtë prizëm, i njëjti këtë mos gatishmëri e ka përdorur si justifikim për mos ndërmarrje të veprimeve në drejtim të parandalimit të vrasjes së Sebahate Sopit.

Konventa e Stambollit është e zbatueshme drejt për së drejti në Kosovë dhe në rast konflikti, ka epërsi ndaj ligjeve të tjera.

Sipas kësaj konvente (neni 5.2.) , *“Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshtetërorë”*, derisa neni 12.3. i kësaj konvente përcakton se *“Çdo masë e marrë sipas këtij kapitulli merr në konsideratë nevojat specifike të personave pa mbrojtje për shkak të rrethanave të veçanta dhe i japin prioritet të drejtave të të gjitha viktimave”*.

Sipas nenit 18.3. të Konventës së Stambollit, shtetet obligohen që, ndër të tjera, masat e ndërmarrja: 1) të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës; 2) të bazohen në një përjasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social; 3) të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor. Po ashtu, në këtë nen të Konventës së Stambollit është përcaktuar se *“Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori veprave penale”*.

Po ashtu, neni 50.1. i Konventës së Stambollit përcakton obligimin e shteteve për të vepruar menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në këto raste derisa neni 51 i kësaj konvente përcakton obligimin e shteteve për të siguruar një vlerësim të rrezikut vdekjeprurës, rrezikut të dhunës së përsëritur dhe faktin se autorët e akteve të dhunës zotërojnë ose kanë qasje në armë të zjarrit.

Të gjitha këto përcaktime të Konventës së Stambollit janë shkelur në rastin e tani të ndjerës Sebahate Sopi. Kjo pasi mos veprimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka shkelur detyrimin për ndërmarrjen e masave parandaluese, për të cilën arsye, 11 ditë më vonë Sebahate Sopi është vrarë. Sebahate Sopi, ashtu si edhe viktimat e tjera nga dhuna në familje, konsiderohen viktima të ndjeshme, ndaj të cilave kërkohet një kujdes i veçantë.

Ndjeshmërinë e viktimës Prokuroria Themelore në Prishtinë e ka përdorur si arsyetim në komunikatë, por jo si fakt ndaj të cilit duhej pasur kujdes gjatë trajtimit të rastit. Përderisa më 3 mars 2021 tani e ndjera kishte shprehur mungesë të vullnetit për të

proceduar tutje (*por se ka deklaruar se ka përjetuar dhunë fizike*), një (1) ditë më vonë e njëjta nuk ishte paraqitur fare për tu ri-intervistuar. Kjo mosgatishmëri e viktimës në dukje të parë flet për indikatorë të jashtëm ndaj Sebahate Sopit, si traditat kosovare, pozitën e pafavorshme të grave në shoqëri, presionin eventual nga familja, ndjenjën e paarsyeshme të përgjegjësisë si dhe eventualisht, kërcënimin apo shantazhin e tani të ndjerës nga ish-bashkëshorti i saj. Ndaj këtyre indikatorëve për presion të jashtëm ndaj një viktime të ndjeshme, kishte heshtur prokurori i rastit. Mos veprimi duke u bazuar në mos gatishmërinë e viktimës për të dëshmuar është në kundërshtim me përgjegjësitë e Shtetit për të zbatuar në mënyrë proaktive obligimet që dalin nga Konventa e Stambollit. Për më tepër, krejt këto obligime burojnë nga Kodi Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera në fuqi.

Përmes kësaj neglizhence të skajshme, rezulton se prokurori i rastit nuk ka bërë fare vlerësimin e rrezikut vdekjeprurës dhe dhunës së përsëritur, ashtu siç kërkohet me Konventën e Stambollit, përkundër faktit se L.S. në vitin 2019 kishte qëndruar në paraburgim për shkak të dhunës në familje dhe se më parë ndaj tij kishte qenë në fuqi edhe një urdhër mbrojtës. Po ashtu, nuk bëhet fjalë për zbatim të Konventës së Stambollit në kuptim të vlerësimit nëse autori i dhunës në familje ka zotëruar ose ka pasur qasje në armë të zjarrit. Prokuroria as që është interesuar të hetojë nëse një gjë e tillë qëndron.

IV. Jurisprudenca e Strasburgut në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetë

Nisur nga rrethanat e rastit, prokurori i këtij rasti ka ditur ose është dashur të dijë se ndaj tani të ndjerës ekziston një rrezik real vdekjeprurës. Një vrasje në këto rrethana nga jurisprudenca e GjEDNj-së cilësohet si shkelje e të drejtës në jetë, jurisprudencë kjo detyrimsht e aplikueshme në rendin kushtetues dhe juridik të Kosovës.

Jurisprudenca e kësaj gjykate thekson se është detyrim i organeve shtetërore që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre (L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar, 1998).

“Në rrethana të përshtatshme, zgjerohet gjithashtu një detyrim pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër” (Osman k. Mbretërisë së Bashkuar, 1998; Kontrova k. Sllovakisë, 2007; Opuz k. Turqisë, 2009).

Në rastin Osman k. Mbretërisë së Bashkuar (par.116), GjEDNj ka sqaruar saktësisht situatat se kur shteti konsiderohet se ka shkelur obligimet pozitive në raport me të drejtën në jetë: *“Sipas Gjykatës, kur ekziston një pretendim se autoritetet kanë shkelur obligimet e tyre pozitive për të mbrojtur të drejtën në jetë në kuptim të*

parandalimit dhe shtypjes së veprës penale kundër personit, duhet të vërtetohet nëse autoritetet e dinin ose është dashur ta dinin ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një apo më shumë individëve nga veprimet kriminale të një pale të tretë, dhe autoritetet kanë dështuar që të marrin masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat masa, gjykuar arsyeshëm, pritej të shmangnin atë rrezik”.

Sipas këtyre standardeve, vrasja e Sebahate Sopit është rast tipik i shkeljes së të drejtës në jetë. Nisur nga fakti se L.S. edhe paraprakisht ka ushtruar dhunë ndaj Sebahate Sopit dhe se herën e fundit rasti është denoncuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë 11 ditë para ditës kritike, ndjeshmërinë e viktimës dhe nivelin e dhunës në familje në shoqëri, kjo prokurori përpos që detyrimisht është dashur të dijë se ka një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën e Sebahate Sopit. Bazuar në dispozitat ligjore, roli i Prokurorit të Shtetit në këtë rast ka qenë që brenda kompetencave ligjore, të ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të parandalimit të këtij rreziku. Sikur Prokurori i Shtetit në rastin konkret në përputhje me kompetencat e tij të ndërmerre masat adekuate që e sigurojnë qëndrimin e viktimës larg ushtruesit të dhunës vrasja ndaj Sebahate Sopit do të shmangej. Njëherit, Shteti ka dështuar edhe që të kërkojë shqiptimin e masave mbrojtëse të parapara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Për këto arsye, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës në jetë.

Njëherit, ky mos veprim është në kundërshtim edhe me standardet e tjera të përcaktuara nga GjEDNj në rastin Opuz k. Turqisë për të vazhduar hetimin dhe veprimet procedurale megjithë tërheqjen e viktimës, duke qenë se, mes tjerash, vepra penale ishte serioze, lëndimet e viktimës ishin fizike, veprimet e të dyshuarit kishin efekt edhe për fëmijët (*ku vetë vajza e së ndjerës kishe denoncuar rastin*), kishte gjasa të mëdha që vepra të përsëritej prapë (*kjo ishte më se e evidente duke qenë se i dyshuari kishte kryer edhe më parë veprime të njejta*), raporti mes kryesit dhe viktimës nuk ishte stabil (*të cilët ishin në një proces divorci*), e të tjera (para. 138-9). Pra, mosveprimi i Prokurorisë vetëm për faktin që e ndjera nuk ishte e gatshme të procedonte personalisht me rastin tutje, janë të paarsyeshme dhe shkelje e hapur e obligimeve kushtetuese e ligjore. Për më tepër, Prokuroria as nuk u interesua të përcaktojë arsyet e mundshme se përse viktima mund të jetë tërhequr nga rasti. Prokuroria thjeshtë u mjaftua me mosprezencën e viktimës në stacion policor, duke shkelur kështu në mënyrë flagrante obligimet e veta (*shih përshtatshmërisht rastin Opuz k. Turqisë*).

Për më tepër, pikërisht duke vlerësuar në bazë të këtyre standardeve, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2013 kishte konkluduar se mos veprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë në rastin e tani të ndjerës Diana Kastrati paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe

neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. “*Ka pasur shkelje të së drejtës për jetë...*”, thuhej në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Për këto arsye, Republika e Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, i ka shkelur Sebahate Sopot të drejtën në jetë, si të drejtën më elementare njerëzore, nga e cila e drejtë rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

Me këtë qasje Prokuroria Themelore në Prishtinë i ka mbyllur dyert për çdo viktimë potenciale të dhunës në familje për të adresuar rastet e tyre sipas obligimeve dhe përgjegjësive që ka shteti për të ofruar mbrojtje, siguri dhe ndjekje penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale.

Me mos veprimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, më 14 mars 2021, janë shuar dy jetë, dhe është shkatërruar një familje si dhe fëmijët kanë mbetur pa të dy prindërit.

Duke vepruar në këtë mënyrë, dëmi ndaj viktimës, familjarëve të viktimës, sistemit të drejtësisë dhe vetë Republikës së Kosovës tanimë është shkaktuar, dhe e gjitha çfarë mbetet është ndërmarrja e masave urgjente për adresimin e llogaridhënies lidhur me këtë rast. Në këtë drejtim, duhet theksuar faktin se shkelja e të drejtës në jetë ndaj një qytetari, e dëmton edhe vetë imazhin e shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe obligimeve që ka Kosova edhe në raport me zbatimin e Konventës së Stambollit.

V. Rekomandimet

Në drejtim të adresimit të llogaridhënies dhe me qëllim që të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve, IKD dhe RrGK kërkojnë nga KPK dhe Kryeprokurori i Shtetit që urgjentisht të pezullojnë nga detyra Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Kujtim Munishi dhe prokurorin e ngarkuar me këtë rast, duke respektuar ligjet dhe procedurat e aplikueshme në këto raste.

Pozita e Kryeprokurorit të Prokurorisë përkatëse dhe ushtrimi i profesionit të prokurorit nuk duhet parë vetëm si privilegj, por në radhë të parë si përgjegjësi para Kushtetutës dhe ligjit si dhe llogaridhënës para sistemit prokurorial dhe qytetarëve të Kosovës. Ligji duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë për secilin qytetar të Kosovës, pa marr parasysh pozitën apo funksionin që e ushtrojnë. Shkelja e të drejtës në jetë ndaj një qytetari për shkak të neglizhencës së sistemit prokurorial duhet të adresohet edhe në aspektin llogaridhënies.

IKD dhe RrGK kërkojnë nga KPK dhe Kryeprokurori i Shtetit:

1. Të formojë një grup punues për të hartuar një raport lidhur me shkeljet dhe veprimet e ndërmarra lidhur me këtë rast, me ç'rast ky grup punues duhet të ketë qasje në të gjitha shkresat e lëndës, në mënyrë që ta zbardhë këtë rast në tërësi. Ky grup punues duhet të përbehet prej pesë (5) përfaqësuesve: Një (1) prokuror (jo nga Prokuroria Themelore në Prishtinë), një (1) mbrojtës i viktimave, një (1) familjar apo përfaqësues i familjes së viktimës dhe dy (2) përfaqësues të shoqërisë civile.
2. Në mënyrë që këto raste të mos përsëriten, të formojë një (1) grup punues me ekspertë të fushës për të shqyrtuar Procedurat Standarde të Veprimit në secilën Prokurori Themelore lidhur me procedurën e pranimit, trajtimit dhe ofrimit të ndihmës për viktimat e dhunës në familje.

Ndërmarrja e këtyre veprimeve është e domosdoshme për të parandaluar praktikat ku shteti dështon në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, ku si rezultat i kësaj, qytetarët e paguajnë me jetën e tyre këtë dështim.

Në anën tjetër, Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së shpreh vullnetin, gatishmërinë dhe përkushtimin e plotë që t'iu ofrojë familjarëve të viktimës ndihmë juridike falas në kuptim të ndjekjes së rrugëve ligjore për konstatimin e shkeljes së të drejtës në jetë ndaj Sebahate Sopit.